



## ALBANIAN UNIVERSITY

### RREGULLORE

#### “PËR FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE BOTIMEVE AKADEMIKE NË ALBANIAN UNIVERSITY”

(*Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe  
Botimeve Akademike*)

Miratuar  
Me VS Nr.8, më 28.12.2016  
Ndryshuar me VS Nr 11, më 15.05.2019

Kryetari i Senatit  
Prof. Dr. Vera Ostrem



**Neni 1**  
**Qëllimi**

Në këtë Rregullore parashikohet organizimi i veprimitarisë kërkimore-shkencore, të drejtat dhe detyrimet e organeve kompetente të Albanian University (AU) dhe pjesëmarrësve të veprimitarisë kërkimore-shkencore, si dhe veprimtaria botuese e AU si pjesë e veprimitarisë kërkimore-shkencore.

**Neni 2**  
**Baza ligjore**

1. AU krijon kushte të përshtatshme për kërkimin shkencor dhe veprimtarinë kërkimore, dhe për të mbështetur stafin akademik që të arrijë rezultate konkuruese në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
2. AU, në realizimin e veprimitarisë kërkimore - shkencore, vepron në përputhje me kuadrin ligjor për arsimin e lartë - Ligjin nr.80/2015, Statutin e AU (neni 68-69), si dhe Rregulloren e saj (neni 16-17).

**Neni 3**  
**Parimet**

Veprimtaria kërkimore-shkencore në AU përfshin këto aktivitete, por ajo nuk kufizohet në:

- Realizimin e kërkimeve shkencore në fushat: Shkenca Mjekësore; Shkenca Shoqërore; si dhe Shkenca të Aplikuara dhe Ekonomike;
- Organizimin e konferencave shkencore kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, të simpoziumeve, të seminareve, dhe bashkëpunimin me institucionet e tjera kërkimore-shkencore brenda vendit dhe jashtë;
- Bashkëpunimin me ndërmarrjet ekonomike dhe industrinë;
- Përgatitjen e studimeve dhe analizave për administratën publike, drejtësinë; ekonominë, mjekësinë, dhe të ngjashme;
- Organizimin e seminareve për zhvillimin profesional të stafit akademik në fushat shkencore relevante të AU;
- Veprimtarinë botuese (botimin e librave, teksteve universitare, monografive dhe revistave shkencore);
- Veprimtaritë e tjera kërkimore-shkencore në fushat që mbulohen nga programet studimore në AU.



## **Neni 4 Interesi publik**

Veprimitaria kërkimore-shkencore në AU realizohet në formë të kërkimeve bazë që janë në lidhje të ngushtë me nevojat e interesit publik.

Përfitues kryesor i aktivitetit kërkimor-shkencor është stafi akademik i AU i angazhuar në realizimin e tij, në përbushje të detyrimeve me karakter individual, ose në grup.

## **Neni 5 Sistemi i realizimit të kërkimit shkencor dhe botimeve akademike**

Në AU, ngrihet dhe funksionon “*Sistemi i realizimit të kërkimit shkencor dhe botimeve akademike*” i cili realizohet nga: (1) Komisioni për Kërkimin Shkencor dhe Botimin; dhe (2) Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike.

### **Neni 6 Komisioni për Kërkimin Shkencor dhe Botimet**

1. Komisioni për Kërkimin Shkencor dhe Botimet Akademike është organ kolegjal, vendimmarrës dhe këshillimor që ngrihet pranë universitetit nga Senati Akademik për organizimin dhe drejtimin e Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike, sipas Statutit të AU (nenet 25, 68,69, 76).
2. Komisioni për Kërkimin Shkencor dhe Botimet ka në përbërje të tij 5 (pesë) anëtarë, ku 4 (katër) anëtarët e këtij komisioni, të cilët janë staf akademik zgjidhen nga Senati Akademik mbi bazë të propozimeve nga Asambleja e Personelit Akademik. Anëtar i pestë është student, dhe zgjidhet nga Këshilli Studentor. Anëtarët e këtij Komisioni zgjidhen për një mandat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rizgjedhje.
3. Ky komision harton dhe orienton politikat e zhvillimit të veprimitarisë kërkimore-shkencore, kontrollon veprimtarinë e Kërkimit Shkencor dhe vendos në lidhje me propozimet e njësive kryesore dhe/ose të zyrës përgjegjëse për kërkimin shkencor, duke i përcjellë ato përmiratim përfundimtar në Senat.
4. Komisioni për Kërkimin Shkencor dhe Botimet, në zbatim të Statutit të AU (neni 76) ka të drejtë të aplikojë, në emër të AU pranë AKKSHI për marrjen e Grantit të punës kërkimore-shkencore, ku bëjnë pjesë edhe fondet për Kërkimin Shkencor.
5. Kompetenca te tjera të Komisionit për Kërkimin Shkencor dhe Botimet janë të përcaktuara në rregulloren e funksionimit të tij.

## **Neni 7 Plani zhvillimit strategjik**

1. Veprimtaritë kërkimore-shkencore për programet dhe projektet e miratuara nga Senati Akademik, bëhen mbi bazën e planit të zhvillimit strategjik të kërkimit shkencor dhe atij institucional të AU.



2. Programet e studimeve të ciklit të tretë, si dhe programet e studimeve të ciklit të dytë, konsiderohen punë kërkimore dhe i nënshtrohen planifikimit shkencor.

### Neni 8

#### Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike

1. Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike kryesohet nën përgjegjësinë e një drejtuesi me gradë ose titull shkencor.
2. ZKKSHBA ka varësi të drejtpërdrejtë nga Rektorati.
3. Kjo zyrë ushtron një sërë kompetencash funksionale ndër të cilat:
  - a. Harton programin dhe planin e punës për çdo vit akademik ku pasqyrohen drejtimet kryesore të veprimtarisë së saj, të miratuar nga Zv. Rektori për Kërkimin Shkencor, si dhe raporton për realizimin e tyre çdo fund semestri pranë Rektoratit.
  - b. Në fillim të çdo viti akademik, harton planin vjetor të kërkimit shkencor për vitin e ri akademik, mbi bazën e planifikimeve të njësive kryesore dhe ia paraqet Komisionit për Kërkimin Shkencor dhe Botimet, i cili, pasi vlerëson performancën e tij, ia kalon për miratim Senatit Akademik.
  - c. Në fund të çdo viti akademik, harton raportin vjetor të kërkimit shkencor, bashkë me një analizë të specializuar për aktivitetet e kërkimit shkencor të realizuara si dhe veprimtarinë botuese të Universitetit: revistën shkencore, tekstet universitare dhe publikimet tjera dhe ia paraqet atë Komisionit për Kërkimin Shkencor dhe Botimet, i cili, pasi vlerëson performancën e tij, ia kalon për miratim Senatit Akademik.
  - d. Bashkërendon punën me njësitë kryesore, njësitë bazë dhe struktura të tjera të universitetit;
  - e. Organizon konsulta për tema dhe probleme të rëndësishme që lidhen me politikat dhe vizionet e njësive të universitetit në tërësi;
  - f. Studion dhe paraqet për miratim në Senatin Akademik projekte kërkimore dhe mësimore duke mbajtur parasysh standardet bashkëkohore;
  - g. Në fillim të çdo viti akademik, mbasi ka marrë propozimet e njësive kryesore, i përcjellë për miratim Komisionit për Kërkimin Shkencor dhe Botimet një tematikë shkencore ndërinstitucionale, ku do të orientohen te gjitha aktivitetet shkencore gjatë atij viti akademik.
  - h. Nxit individualisht pedagogët dhe drejtuesit e njësive bazë për punë kërkimore-shkencore, si dhe nëpër projekte në shkallë universiteti, njësie kryesore apo njësie bazë;
  - i. Bashkërendon dhe koordinon veprimtaritë kërkimore të departamenteve, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik;
  - j. Promovon veprimtarinë kërkimore-shkencore të universitetit, brenda dhe jashtë vendit;
  - k. Punon për marrëdhënie dhe projekte të përbashkëta ndëruniversitare me të tjera Institucione të Arsimit të Lartë, Institucione kërkimore-shkencore, kulturore dhe ekonomike, publike dhe private, brenda dhe jashtë vendit;
  - l. Kontribuon në përfshirjen e personelit akademik të universitetit në projekte ndëruniversitare apo institucionale;
  - m. Ndjek zbatimin e orientimeve, planeve, projekteve, tematikave dhe problematikave të miratuara nga njësitë bazë;



- n. Përgjatë dhe në fund të çdo viti akademik, raporton për veprimtarinë kërkimore-shkencore pranë Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik ku dhe kryhen vlerësimet përkatëse;
- o. Siguron publikimet e artikujve shkencor të personelit akademik të Albanian University në Revistën Shkencore të universitetit dhe realizon publicitetin e këtyre botimeve - Revista dhe libra të ndryshëm, etj.

**Neni 9**  
**Zv/Rektori përgjegjës për Kërkimin Shkencor**

1. Zv/Rektori për Kërkimin Shkencor është përgjegjës për mbarëvajtjen e Zyrës së Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike.
2. Ai miraton programin dhe planin e punës dhe mbikëqyr veprimtarinë e kësaj Zyre.

**Neni 10**  
**Botimi i teksteve universitare**

1. Çdo pedagog i angazhuar me kohë të plotë pranë AU, ka të drejtë të kërkojë mbështetje për botimin e teksteve universitare, në përputhje me literaturën e programeve të studimit të ofruar nga AU.
2. Teksti universitar, pasi të ketë kaluar vlerësimin shkencor nga jo me pak se dy specialistë të fushës, dërgohet nga pedagogu pranë Departamentit për miratim si literaturë bazë ose plotësuese e programit të studimit përkatës.
3. Nëse teksti vlerësohet pozitivisht nga Departamenti, miratohet edhe financiarisht, në bazë të procedurave të përcaktuara në këtë rregullore.
4. Shtëpia Botuese Albanian University Press, si njësi shërbimi pranë Albanian University procedon me prodhimin e tekstit, i cili do të mbajë logon e saj.
5. Pesë kopje të tekstit dorëzohen në Bibliotekën Kombëtare. Tre kopje të tekstit depozitohen në Bibliotekën Universitare të AU, të tjerat shpërndahen sipas kontratës përkatëse që nënshkruan pedagogu me universitetin.
6. Botimi i teksteve universitare, koordinohet nga Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike.

**Neni 11**  
**Financimi i kërkimit shkencor dhe botimeve**

Veprimtaria kërkimore - shkencore financohet nga buxheti i AU për kërkime shkencore si dhe nga pjesëmarrja e partnerëve dhe donatorëve të jashtëm bashkëpjesëmarrës në projektet e përbashkëta.

Buxheti i AU për kërkimet shkencore mbulon:

- Investime për bashkëfinancim-pjesëmarrje në projekte kërkimore-shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare të institucionit në shumën e përcaktuar në marrëveshjet e bashkëpunimit ose kontratat me partner të ndryshëm;
- Organizimin e konferencave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare të Albanian University;



- Shpenzimet për botimin e Revistës OPTIME;
- Financime për pjesëmarrje në konferanca shkencore ndërkontinentale, work-shope, botime të punimeve shkencore në revista shkencore ndërkontinentale me faktor impakti etj. të personelit akademik me kohë të plotë në AU sipas procedurës së përcaktuar në këtë rregullore;
- Shpenzimet për botimin e teksteve universitare të personelit akademik me kohë të plotë në AU, në përputhje me literaturën e programeve të studimit të ofruar nga AU.

Masa financiare për mbulimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore në AU miratohet nga Bordi i Administrimit, bazuar në propozimin e Senatit akademik në kuadër të propozimit të buxhetin vjetor të AU.

### **Neni 12** **Financimi për personelin akademik**

1. Çdo pedagog i angazhuar me kohë të plotë pranë AU, ka të drejtë të kërkojë financime për pjesëmarrje në konferanca shkencore ndërkontinentale, work-shope, botime të punimeve shkencore në revista shkencore ndërkontinentale me faktor impakti etj. në aktivitete shkencore ose botime akademike në fushën ose tematikën që përbën prioritet për kërkimin shkencor për departamentin përkatës.
2. Kërkesa i drejtohet ZKKSHBA ose njësisë bazë nga pedagogu dhe pasi është marrë miratimi nga administratori i përgjithshëm apo i njësisë kryesore, bazuar në buxhetin vjetor të miratuar nga Bordi i Administrimit, i kalon zyrës së financës për zbatim.

### **Neni 13** **Financimi i teksteve universitare**

1. Çdo pedagog i angazhuar me kohë të plotë pranë AU, ka të drejtë të kërkojë mbështetje për botimin e teksteve universitare, në përputhje me literaturën e programeve të studimit të ofruar nga AU.
2. Pedagogu paralelisht me kërkesën për miratim të tekstit si literaturë (neni 10 i kësaj rregullore), i paraqet departamentit edhe kërkesën për financim të tij nga AU.
3. Departamenti i mbështetur nga ZKKSHBA, i përcjellë administratorit të fakultetit propozimin. Ky i fundit, vlerëson kostot e tekstit bazuar në buxhetin vjetor të miratuar nga Bordi i Administrimit.
4. Nëse prodhimi i tekstit nuk i kalon parashikimet e buxhetit të departamentit përkatës, miratohet prodhimi i tij.
5. Në këtë moment pedagogu nënshkruan kontratën e botimit të tekstit me universitetin dhe i kalon Shtëpisë Botuese Albanian University Press për shtyp.
6. Pesë kopje të tekstit dorëzohen në Bibliotekën Kombëtare. Tre kopje të tekstit depozitoohen në Bibliotekën Universitare të AU, të tjerat shpërndahen sipas kontratës përkatëse që nënshkruan pedagogu me universitetin.
7. Botimi i teksteve universitare, koordinohet nga Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike.

### Neni 13



### Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit në Senatin Akademik dhe firmosjes nga Kryetari i tij.

Miratuar me Vendimin nr. 11 të Senatit Akademik, datë 15.05.2019.

